



KUVENDI I PUNËS DHE STATUTAR I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

23.03.2026

3.0

PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Grupet e interesit
- Partnerët & sponsorët
- **Raporti i punës për vitin 2025**
 - Organizimet ndërkombëtare
 - Përfaqësimi në arenën ndërkombëtare
 - Klubet e Kosovës në gara ndërkombëtare
 - Garat vendore dhe kampionët
 - Ngritja e kapaciteteve
 - Komuniteti i basketbollit dhe përfaqësimi vendor e ndërkombëtar
 - Projektet ndërkombëtare dhe zhvillimore

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

- Më të mirët e vitit 2025
- Qeverisja dhe aktiviteti i Bordit
- Aktet normative
- Stafii zyrës ekzekutive
- Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun
- Basketbolli 3.0 dhe Podcast "n'rrjetë"
- Sfidat kryesore të vitit 2025
- **Raporti Financiar për vitin 2025**
- **Plani i Veprimit për vitin 2026**
 - Identifikimi i talenteve & zhvillimi afatgjatë
 - Synimet për vitin 2026
 - **Marketingu dhe Komunikimi – Synimet për vitin 2026**
- **Plani Financiar 2026**



HYRJE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Viti 2025 shënon përmbylljen e ciklit të Planit Strategjik 2021–2025 dhe njëkohësisht hap një fazë të re zhvillimore për Federatën e Basketbollit të Kosovës. Gjatë këtij cikli, FBK ka konsoliduar modelin e saj të planifikimit strategjik, duke kaluar nga një qasje reaktive drejt një sistemi të strukturuar me prioritete të qarta, objektiva të matshme dhe kapacitete institucionale të forcuara.

Organizimi i suksesshëm i ngjarjeve madhore të FIBA-s, si dhe vizitat e drejtuesve më të lartë të FIBA Evropës gjatë vitit 2025, kanë konfirmuar FBK-në si një partner të besueshëm ndërkombëtar dhe një organizator me standarde evropiane, duke rritur dukshëm profilin e Kosovës në basketbollin evropian.

Në aspektin sportiv, rezultati historik i Përfaqësueses U20 të Kosovës në Divizionin B dhe pjesëmarrja e plotë e ekipeve kombëtare në garat evropiane dëshmojnë se investimi në zhvillimin e talenteve dhe në strukturimin e sistemit të ekipeve kombëtare është një drejtim strategjik i qëndrueshëm për të ardhmen.

Gjatë vitit 2025, basketbolli për vajza dhe gra është shndërruar nga një iniciativë projektuale në një prioritet strategjik të Federatës. Organizimi i FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C për Vajza dhe pjesëmarrja historike në FIBA EuroCup Women krijojnë një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm të basketbollit të femrave në ciklin e ardhshëm strategjik.

Në të njëjtën kohë, zbatimi i projekteve ndërkombëtare si "Safeguarding the Future" dhe avancimi i politikave të mbrojtjes kanë forcuar standardet e qeverisjes, integritetit dhe përgjegjësisë institucionale, duke e pozicionuar FBK-në në përputhje me praktikën më të mira evropiane.



HYRJE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

FBK hyn në periudhën 2026–2030 me dy dokumente strategjike të harmonizuara:

- **Planin Strategjik të FBK-së 2026–2030**, si kornizë për zhvillimin institucional dhe sportiv të basketbollit në Kosovë.
- **Strategjinë për Basketbollin 3x3**, si investim i fokusuar në një disiplinë me potencial të lartë ndërkombëtar dhe perspektivë të rëndësishme drejt garave multi-sportive.

Kombinimi i një strategjie të përgjithshme për basketbollin dhe një strategjie të specializuar për 3x3 i mundëson FBK-së të zhvillojë në mënyrë të balancuar të gjithë ekosistemin e basketbollit, duke investuar njëkohësisht në disiplinat me potencial të madh për sukses ndërkombëtar dhe zhvillim afatgjatë.

30

GRUPET E INTERESIT

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Kuvendi i FBK-së

Bordi Ekzekutiv
dhe Zyra
Ekzekutive e
FBK-së

Klubet e
basketbollit

Komisionet e
FBK-së

Përfaqësueset,
basketbollistët/et,
trajnerët/et dhe
gjyqtarët/et

Komitetet Lokale
Organizative

Ambasadorët e
basketbollit të
Kosovës

Institucionet
shtetërore dhe
komunale

Partnerët
ndërkombëtarë

Partnerët medial
dhe sponsorët

Shoqatat e
komunitetit dhe
organizatat
joqeveritare

Universitetet
dhe
institucionet
arsimore

Shkollat dhe
mësuesit e
edukimit fizik

Operatorët e
teknologjisë dhe
platformave
digjitale

Tifozët,
vullnetarët dhe
ekipet
mjekësore

30

PARTNERËT & SPONSORËT

FBK VAZHDON PARTNERITETET E RËNDËSISHME NË 2025

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Partnerë Strategjikë



Sponsorë të Përgjithshëm



Partnerë Medialë



Sponsorë të Federatës



Partner Teknik Zyrtar



Partnerë Zyrtarë



30



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS,
RINISË DHE SPORTIT

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

MKRS partner strategjik

Federata e Basketbollit të Kosovës gjatë vitit 2025 ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me MKRS, konform procesit të kategorizimit të sporteve.

MKRS gjithashtu ka mbështetur FBK-në financiarisht edhe në këto aktivitete:

- FIBA U16 Kampionati Evropian për Vajza, Divizioni C (Pejë)
- Kualifikimet për FIBA 3x3 Europe Cup (Prishtinë)
- FIBA Europe U14 Get-Together
- Takimi i Komisionit të të Rinjve të FIBA Europe
- FIBA 3x3 Challenger Prishtina

Ky partneritet strategjik ka luajtur një rol vendimtar në organizimin dhe zhvillimin e basketbollit në vend.

30

SPONSORËT

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

FBK VAZHDON PARTNERITETET E RËNDËSISHME NË 2025

Federata e Basketbollit të Kosovës është krenare që në vitin 2025 ka rinovuar bashkëpunimin me partnerët tanë besnikë: **ProCredit Bank, TEB Bank, Art Motion & Kujtesa, Albi Mall, Auto Mita** dhe **Korporata Rugove**.

Ndërkaq, këtë vit, familjes së FBK-së i janë bashkuar edhe kompanitë me renome: **Sava & Illyria Life**.

Këto kompani nuk janë thjesht sponsorë; ato janë partnerë strategjikë që ndajnë vizionin tonë për rritjen dhe zhvillimin e basketbollit në Kosovë.

ProCredit Bank vazhdon të jetë sponsori gjeneral i produktit kryesor të Federatës, Superliga Meshkujt.

TEB Bank ka mbështetur me krenari Përfaqësueset e Kosovës, duke investuar në suksesin e tyre ndërkombëtar.

Art Motion & Kujtesa, si partner medial, ka sjellur emocionet e garave të basketbollit direkt në ekranet tuaja, duke i afruar tifozët më shumë se kurrë më parë.

Sava & Illyria Life, Albi Mall, Auto Mita, dhe Korporata Rugove mbeten shtylla kryesore për organizimin e garave dhe aktiviteteve që pasurojnë basketbollin tonë.

30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

2025 RAPORTI I PUNËS

30

ORGANIZIMET NDËRKOMBËTARE 2025

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Federata e Basketbollit e Kosovës ka organizuar një sërë eventesh të rëndësishme ndërkombëtare të FIBA-s, duke forcuar reputacionin ndërkombëtar të Kosovës si një organizatore e besueshme e ngjarjeve të basketbollit.

Ngjarjet e organizuara janë:

- FIBA U16 Kampionati Evropian për Vajza, Divizioni C (Pejë)
- Kualifikimet për FIBA 3x3 Europe Cup (Prishtinë)
- FIBA Europe U14 Get-Together
- Takimi i Komisionit të të Rinjve të FIBA Europe
- FIBA 3x3 Challenger Prishtina (organizim nga klubi i 3x3 Prishtina)

Këto organizime kontribuuan në:

- Rritjen e reputacionit ndërkombëtar të Kosovës
- Zhvillimin e diplomacisë sportive
- Avancimin e kapaciteteve organizative të FBK
- Krijimin e mundësive për organizime edhe më të mëdha në të ardhmen.

30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës



ORGANIZIMET NDËRKOMBËTARE 2025

FBK gjithashtu priti në Kosovë drejtuesit më të lartë të FIBA Europe, përfshirë:

- Presidentin e FIBA Europe, Jorge Garbajosa
- Drejtorin Ekzekutiv të FIBA Europe, Kamil Novak

Kjo vizitë përbën një vlerësim të drejtpërdrejtë për zhvillimin institucional të FBK-së.

30

Përfaqësueset e Kosovës në arenën ndërkombëtare

Kosova është përfaqësuar me gjithsej **11** ekipe kombëtare në gara ndërkombëtare:

- **Kosova A (Meshkujt)**
- **Kosova 3x3 (Meshkujt & Femrat)**
- **Kosova U20 (Meshkujt)**
- **Kosova U18 (Femrat)**
- **Kosova U18 (Meshkujt)**
- **Kosova U16 (Femrat)**
- **Kosova U16 (Meshkujt)**
- **Kosova U14 (Djemtë & Vajzat)**
- **Kosova e-FIBA**

Rezultati më i rëndësishëm sportiv ishte: **Kosova U20 Meshkujt** – vendi i 8 në **Kampionatin Evropian, Divizioni B**, që përbën suksesin më të madh të kategorive të reja të Kosovës që nga pranimi në FIBA.



Kosova A (Meshkujt) zhvilloi tri ndeshje gjatë vitit 2025 me bilanc: 2 fitore, 1 humbje në kuadër të:

- Para-kualifikimeve për Kupën e Botës 2027;
- Para-kualifikimeve për EuroBasket 2029.

Federata
e Basketbollit
të Kosovës



30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

KLUBET E KOSOVËS NË GARA NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2025 klubet kosovare morën pjesë në disa gara evropiane dhe rajonale

Këto pjesëmarrje kanë kontribuar në rritjen e nivelit konkurrues dhe në promovimin ndërkombëtar të basketbollit kosovar.



Basketball Champions League
dhe FIBA Europe Cup



FIBA Europe Cup



EuroCup Women



European North Basketball League
(ENBL)



European North Basketball League
(ENBL)

30



Federata
e Basketbollit
të Kosovës

- **Kategoria seniore**
 - ProCredit Superliga
 - Superliga Femrat
 - Liga e Parë Femrat
 - Liga e Parë Meshkujt
 - Liga e Dytë Meshkujt
 - Kupa e Kosovës Femrat
 - Kupa e Kosovës Meshkujt
 - Superkupa Femrat
- **Kategoritë e Reja: 13 liga**
- **Garat e veteranëve**

Garat e FBK-së



30

GARAT VENDORE DHE KAMPIONËT

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Sezoni 2024/2025 u karakterizua nga konkurrenca e fortë në të gjitha garat

Meshkujt



- Kampion i ProCredit Superligës: **KB Trepça**
- Fitues i Kupës së Kosovës: **KB Trepça**



Femrat



- Kampione e Superligës: **KBF Bashkimi**
- Fitues i Kupës së Kosovës: **KBF Bashkimi**
- Fitues i Superkupës: **KBF Peja 03**



Liga Unike



- Kampion i Ligës Unike Meshkujt: **KB Vëllaznimi**
- Kampion i Ligës Unike Femrat: **KBF Flamurtari**



FBK organizoi në total **24** gara

30

NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Adriatik Rraci
diplomoi me
sukses në
programin ASMC

Teuta Abdullahu
diplomoi në
programin
FIBA WiLead

Artina Hasani dhe
Fisnik Juniku
diplomuan në
programin FIBA
Time-Out 3.0

Dorant Hana
përfaqësoi Kosovën
në programin
ndërkombëtar për
trajnerë ICAB

Vazhdimi i
programit të
mentorimit për
gjiqtarët e rinj

Organizimi i Kursit
për Administratorë
të Basketbollit në
bashkëpunim
me KOK

Seminari për
trajnerët e
basketbollit për
grupmoshat e reja

FIBA SCOD
Klinika për
gjiqtarët vendorë

Kampi i FIBA
Gjiqtarëve
Potencial

Klinika për
arsimtarët /
trajnerët e
basketbollit 3x3

30

KOMUNITETI I BASKETBOLLIT, PËRFAQËSIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

FBK, shembull
suksesi në
Kongresin e FIBA
Botës

Arben Fetahu dhe
Elvira Dushku
morën pjesë në
Kongresin e FIBA
Botës

Fetahu dhe Dushku
morën pjesë në
Asamblenë e
Përgjithshme të
FIBA Evropës

Fetahu u zgjodh
Nënkryetar i
Komitetit Olimpik
të Kosovës,
ndërsa Florian
Miftari anëtar i
Bordit Ekzekutiv

Adriatik Rraci
përzgjidhet në
programin
prestigjioz të FIBA

"FIBA Academy
Strategic Leaders"

Dushku
ligjëruese në
programin FIBA
Time-Out 3.0

Artina Hasani
dhe Rrezarta
Kqiku pjesë e
FIBA EuroBasket
2025 në Qipro

Edita Medunjanin
pjesë e FIBA Open
2025 në Zvicër

Dushku,
Medunjanin dhe
Kqiku në Forumin
final të projektit
PROMISE

Jeta Zeka
përfaqësoi
Kosovën në
FIBA Women's
Basketball
Summit

Granit Rugova
pjesë e punëtorisë
për JR NBA

Rugova dhe
Obërtinca pjesë
e Konventës së
Minibasketbollit

30

KOMUNITETI I BASKETBOLLIT, PËRFAQËSIMI VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Enea Hajdari në
Konferencën e 3-të
të BAT (Tribunali i
Arbitrazhit të
Basketbollit)

Vlora Braha –
Delegatja e parë
Teknike nga Kosova
në një ndeshje
kualifikuese të FIBA
EuroBasket për
femra

Faton
Kurshumlija
rikualifikohet si
instruktur i FIBA
për gjyqtarët

FBK me 6
gjyqtarë të
licencuar nga
FIBA për
periudhën
2025–2027, për
herë të parë
edhe një femër

Gjyqtarët
kosovarë ndajnë
drejtësinë në FIBA
Kampionatet
Evropiane të
Gjeneratave të
Reja

Gjyqtarët e
Kosovës ndajnë
drejtësinë në
turneun
ndërkombëtar
"Copenhagen
Invitational
2025"

Jeta Zeka dhe
Genc Vitaku në
FIBA Kampin e
Gjyqtarëve

9 trajnerë nga
basketbolli
pranohen në
programin
"Trajner Sportiv"
të KOK

Malvina Haziri
dhe Yll Kastrati
përfitojnë bursa
olimpike nga
KOK

FBK, bursa për
studentët e
Fakultetit të
Edukimit Fizik dhe
Sportit – Bleona
Juniku dhe
Adhurim Aliaj

Themelimi i
Shoqatës së
Basketbollistëve
dhe
Basketbollisteve
të Kosovës

FBK nënshkruan
deklaratën
"Brighton Plus
Helsinki" për
barazi gjinore
në sport

30

PROJEKTET NDËRKOMBËTARE DHE ZHVILLIMORE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

- **Safeguarding the Future** (Erasmus+)
- **PROMISE** (Erasmus+)
- **Shooter – Digitalisation in Basketball** (Erasmus+)
- **FIBA Europe Youth Development Fund** (FIBA Europe)
- **Alley Oop** (FIBA Europe)
- **Sport në Shkolla 3x3** (MKRS)
- **Junior NBA Kosova** (NBA)
- **Her World Her Rules** (FIBA Europe)
- **Hoops & Words – Basketball for Good** (FIBA)



30

MË TË MIRËT E VITIT 2025

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Federata e Basketbollit të Kosovës



Basketbollisti i vitit
Dardan Berisha

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës

Top 5



Dardan Berisha, Dardan Kapiti, Don Polloshtra, Mikaile Tmusic, Veton Bunjaku


Meshkujt

Federata

ART MOTION

Federata e Basketbollit të Kosovës

Çmimi i publikut Meshkujt



Mikaile Tmusic

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës

Klubi më i mirë Meshkujt



KB Trepça

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shpresa e vitit tek djemtë



Besim Bytyqi

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës



Basketbollistja e vitit
Malvina Haziri

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës

Top 5



Malvina Haziri, Agnesa Rrahmani, Alkona Muhadri, Elisa Kamerolli, Merisa Bilalli

Femrat

Federata

kutesa

Federata e Basketbollit të Kosovës

Çmimi i publikut Femrat



Agnesa Rrahmani

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës

Shpresa e vitit tek vajzat



Elsa Shala

Federata

Federata e Basketbollit të Kosovës

Klubi më i mirë Femrat



KBF Bashkimi

Federata


30

MË TË MIRËT E VITIT 2025

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Federata e Basketbollit të Kosovës

Ambasadori i basketbollit të Kosovës jashtë vendit




Andin Rashica

La Organtët

Federata e Basketbollit të Kosovës

Trajneri më i mirë i vitit




Bujar Loci

La Organtët

Federata e Basketbollit të Kosovës

Gjyqtari i vitit



Amar Djekovic

La Organtët

Federata e Basketbollit të Kosovës

Punëtori më i dalluar i vitit




Rrahman Përteshi

La Organtët

Federata e Basketbollit të Kosovës

Kontribuues i basketbollit



Mazllom Jevriqi

La Organtët

Federata e Basketbollit të Kosovës

Veteranja e vitit



Shemsije Stublla

La Organtët

Federata e Basketbollit të Kosovës

Veterani i vitit



Valdet Spahija

La Organtët

30


Federata
e Basketbollit
të Kosovës

QEVERISJA DHE AKTIVITETI I BORDIT

Gjatë vitit 2025, Bordi i FBK ka zhvilluar një aktivitet intensiv institucional.

Statistikat kryesore:

- 35 vendime të miratuara
- 5 takime fizike të Bordit




30

AKTET NORMATIVE DHE RREGULLORET

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Gjatë vitit 2025 janë miratuar dhe përditësuar një numër rregulloresh të rëndësishme, si:



- Statuti i FBK (përditësim sipas Ligjit të ri të Sportit)
- Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të FBK
- Rregullorja për Regjistrimin dhe Kalim në FBK
- Rregullorja për Licencim dhe Garim
- Propozicionet e Garave për Ligat Seniore
- Propozicionet e Garave për Kategoritë e Reja
- Rregullorja për Turneun U10
- Rregullorja për Shpalljen e Laureatëve



30

STAFI I ZYRËS EKZEKUTIVE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës





KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

NUMRI I NDESHJEVE TË TRANSMETUARA NË EDICIONIN 2024 - 2025

Superliga
Meshkujt

154

ndeshje të
transmetuara
në ART MOTION

Superliga
Femrat

26

ndeshje të
transmetuara
në ART MOTION

Liga e Parë
Meshkujt

69

ndeshje të
transmetuara
në YOUTUBE

NUMRI I NDJEKËSVE NË RRJETET SOCIALE NË EDICIONIN 2024 - 2025

Facebook

44.2M

Shikime

Instagram

43.2M

Shikime

X

1150

Ndjekës

TikTok

2533

Ndjekës

LinkedIn

564

Ndjekës

YouTube

9.03K

Abonues

3.0

Basketbolli 3.0 – Koncepti i ri i identitetit të basketbollit në Kosovë

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Federata e Basketbollit e Kosovës prezantoi konceptin "Basketbolli 3.0", një identitet i ri vizual dhe komunikues që synon modernizimin e imazhit të basketbollit kosovar dhe afrimin e tij me audiencën e re.

Koncepti përfaqëson një fazë të re të zhvillimit të sportit dhe mbështetet në tri parime kryesore:

- **Transformim** – zhvillimi dhe modernizimi i basketbollit në Kosovë
- **Përfshirje** – zgjerimi i komunitetit të basketbollit dhe pjesëmarrja e të rinjve
- **Inovacion** – përdorimi i komunikimit modern dhe platformave digjitale



Objektivat kryesore:

- Rritja e pjesëmarrjes në basketboll
- Zhvillimi i talenteve të reja dhe përfshirja e vajzave në sport
- Përmirësimi i imazhit ndërkombëtar të basketbollit kosovar
- Zgjerimi i bazës së tifozëve dhe angazhimi i komunitetit sportiv

30

Podcast n'rrjetë

Platforma e re e komunikimit të FBK-së

Federata e Basketbollit të Kosovës ka zhvilluar edhe podcastin zyrtar të federatës "n'rrjetë", një platformë e re komunikimi për promovimin e basketbollit dhe për afrimin e komunitetit sportiv me publikun.

Emri "n'rrjetë" lidhet me dy kuptime kryesore:

- Rrjeta e koshit të basketbollit
- Rrjetëzimi me ngjarjet dhe informacionet në botën e basketbollit

Podcasti synon të:

- Promovojë basketbollistët dhe historitë e tyre
- Risë transparencën dhe komunikimin me komunitetin e basketbollit
- Sjellë analiza dhe diskutime mbi zhvillimet në basketboll
- Krijojë përmbajtje moderne për platformat digjitale

Ky format komunikimi është pjesë e strategjisë së FBK-së për modernizimin e komunikimit publik dhe rritjen e vizibilitetit të basketbollit kosovar në media dhe rrjete sociale.



30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

SFIDAT KRYESORE TË VITIT 2025

- Mungesa e infrastrukturës sportive adekuate për zhvillimin e basketbollit në të gjitha nivelet
- Varësia e lartë nga financimi publik, veçanërisht nga mbështetja qeveritare
- Numri i pamjaftueshëm i trajnerëve të licencuar, veçanërisht në kategoritë e reja
- Investimet e pamjaftueshme të klubeve në zhvillimin e gjeneratave të reja
- Mungesa e ekspertëve vendorë në fusha specifike të zhvillimit të basketbollit
- Numri i kufizuar i lojtarëve të specializuar në disiplinën 3x3
- Deficiti financiar në raport me nevojat për zhvillimin e programeve dhe aktiviteteve
- Përfshirja e ulët e vajzave dhe grave në basketboll dhe sport në përgjithësi
- Niveli i ulët i përfshirjes së të rinjve në rajonet rurale
- Mungesa e strategjive të qëndrueshme për zhvillimin dhe motivimin e tifozëve të rinj
- Rezultatet e kufizuara të Përfaqësueses A të Kosovës në garat ndërkombëtare

30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

2025 RAPORTI FINANCIAR



TË HYRAT E FBK-SË PËR VITIN 2025

Sipas Buxhetit të FBK-së për vitin 2025, ishte parashikuar realizimi i të hyrave prej **€2,539,239.70**

Gjatë vitit 2025, FBK ka realizuar **75.5%** të këtyre zotimeve, duke arritur një total prej **€1,917,005.20**, me një devijim negativ prej **€622,234.50** (-24.5%)

30

RAPORTI FINANCIAR 2025

→ **Totali i të hyrave: € 1,917,005.20**

→ **Totali i shpenzimeve: € 2,275,126.66**

→ **Rezultati neto: € 358,121.46**



30

KRAHASIMI ME VITIN 2024


Federata
e Basketbollit
të Kosovës



TË HYRAT TOTALE:

Rënie prej **€72,052.80 (-3.6%)** krahasuar me vitin 2024


TË HYRAT		KRAHASIMI ME 2024
Sponsorët	€759,500	-26%
MKRS	€571,382	+136.2%
FIBA	€216,790.60	-26.9%
Aktivitetet	€369,332.60	-13%



30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës


**STRUKTUURA
E TË HYRAVE
SIPAS
KATEGORIVE**



30

STRUKTURA E SHPENZIMEVE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës



**Totali i
shpenzimeve:
€2,275,126.66**

30

SHIPENZIMET E FBK-SË PËR VITIN 2025

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Totali i shpenzimeve për vitin 2025 është **€2,275,126.66**,
që paraqet një **ulje të lehtë prej €38,835.34 apo -1.7%** krahasuar me vitin 2024.

Humbja totale është rritur, kryesisht për shkak të rënies së të hyrave, pavarësisht
uljes së vogël të shpenzimeve operative.

ANALIZA FINANCIARE

Rritje/ulje e të hyrave në krahasim me vitin 2024: **4% ulje**

Rritje/ulje e shpenzimeve në krahasim me vitin 2024: **2% ulje**

Pjesëmarrja e financimit privat: **40%**

Pjesëmarrja e financimit publik: **30%**

30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

2026 PLANI I VEPRIMIT

30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

IDENTIFIKIMI I TALENTEVE &

ZHVILLIMI

AFATGJATË

(LTAD 2026-2030)

QËLLIMI

- Ndërtimi i një sistemi kombëtar të strukturuar të zhvillimit të lojtarëve
- Fokus në zhvillim afatgjatë, jo vetëm rezultat afatshkurtër

PARIMET KRYESORE

- Zhvillimi i orientuar te lojtari
- Mësimi përmes lojës
- Specializimi i vonuar
- Zhvillimi i gjithanshëm i lojtarit

VIZIONI

- Lojtarë:
 - Teknikisht të kompletuar
 - Taktikisht inteligjentë
 - Fizikisht të përgatitur
 - Mentalisht të qëndrueshëm

MODELI I ZHVILLIMIT

IDENTIFIKIMI I TALENTEVE

- Proces afatgjatë dhe multidimensional
- Dimensionet:
 - Teknik
 - Taktik
 - Fizik
 - Psikologjik
 - Social / etik

INSTRUMENTET KRYESORE

- Formulari i skautimit të talenteve
- Modeli i zhvillimit fizik sipas moshës
- Ditari i zhvillimit teknik sipas moshës
- Programi LTAD (U6–U20)

MODELI SIPAS MOSHËS

- “Gjërat e duhura në kohën e duhur”
- U6–U10 → Zhvillim motorik dhe kënaqësi në lojë
- U11–U14 → Bazat teknike dhe koordinimi
- U15–U18 → Zhvillim taktik dhe performancë
- U18+ → Performancë elitare

IMPLEMENTIMI INSTITUCIONAL & STRUKTURA

- Programi do të funksionojë si strukturë brenda Departamentit për Projekte dhe Programe Zhvillimore të FBK-së
- Nga 1 Maj 2026 janë angazhuar 2 trajnerë të dedikuar për zbatimin e programit



Synimet për vitin 2026

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

1. FUQIZIMI I PËRFAQËSUESEVE TË KOSOVËS

- Paraqitje konkurruese në parakualifikimet për FIBA EuroBasket 2029.
- Pjesëmarrja e përfaqësueseve të të gjitha kategorive në kampionatet evropiane të FIBA-s.
- Përmirësimi i renditjes ndërkombëtare të Kosovës në FIBA.

2. ORGANIZIMI I NGJARJEVE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË

- Organizimi i kualifikimeve për FIBA 3x3 Europe Cup
- Organizimi i FIBA Kampionatit Evropian për Shtetet e Vogla, Femrat
- Organizimi i FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, Femrat

Këto evente synojnë të rrisin vizibilitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe reputacionin organizativ të FBK-së.

3. ZHVILLIMI DHE MASIVIZIMI I BASKETBOLLIT 3X3

- Organizimi i garave 3x3 në shkolla dhe komunitete.
- Profilizimi i lojtarëve, trajnerëve dhe gjyqtarëve për disiplinën 3x3.
- Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të FIBA 3x3.
- Përgatitja e bazës për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.

4. ZHVILLIMI I TALENTEVE DHE BASKETBOLLIT PËR TË RINJ

- Identifikimi dhe zhvillimi i talenteve të reja në grupmoshat e reja.
- Zhvillimi i programeve si MiniBasketbolli dhe Jr. NBA Kosova.
- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në basketboll.

Synimet për vitin 2026



Federata
e Basketbollit
të Kosovës

5. FUQIZIMI DHE PROFESIONALIZIMI I KLUBEVE

- Digjitalizimi i procesit të licencimit të klubeve.
- Organizimi i seminareve për qeverisje të mirë, marketing dhe transparencë.
- Mbështetje për zhvillimin organizativ të klubeve.

6. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE

- Edukimi i trajnerëve, gjyqtarëve dhe administratorëve të sportit.
- Pjesëmarrja në programe ndërkombëtare të FIBA dhe KOK.
- Investimi në zhvillimin profesional të stafit të federatës.

7. RITJA E PJESËMARRJES SË VAJZAVE DHE GRAVE NË BASKETBOLL

- Programe të veçanta për vajza dhe gra në basketboll.
- Rritja e numrit të trajnerëve dhe gjyqtareve femra.
- Promovimi i barazisë gjinore në sport.

8. RITJA E VIZIBILITETIT DHE ZHVILLIMI I MARKETINGUT

- Forcimi i pranisë së FBK-së në media dhe rrjete sociale.
- Rritja e angazhimit të komunitetit dhe tifozëve.
- Zhvillimi i sponsorizimeve dhe partneriteteve strategjike.

9. STABILITETI FINANCIAR DHE QEVERISJA E MIRË

- Diversifikimi i burimeve të financimit.
- Zbatimi i standardeve të transparencës dhe integritetit në sport.
- Implementimi i politikave të Safeguarding dhe sportit të pastër.

30

PUNA ME KLUBET DHE ANËTARËT E TYRE

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

- Fuqizimi dhe digjitalizimi i procesit të **licencimit të klubeve**
- Organizimi i **tri seminareve për klubet** (antidoping, politikat për mbrojtje dhe kundër ndeshjeve të fiksuara, marketingut & vizibiliteti si dhe transparenca dhe qeverisja e mirë)
- Paraqitja e klubeve në **garat ndërkombëtare** (dy konkurrencat)
- Shpërblimet e njëjta në **dy konkurrencat**
- **Donacionet** (veshmbathje sportive, topa)
- Fuqizimi i bashkëpunimit/komunikimit me **klubet**
- Organizimi i takimeve në mes klubeve dhe krerëve të **FBK-së** (para fillimit të edicionit, gjatë edicionit dhe pas përfundimit të edicionit)
- Organizimi i takimeve me palët e tjera të interesit dhe krerëve të **FBK-së**



30

Marketingu dhe Komunikimi

Synimet për vitin 2026

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

1. FUQIZIMI I IDENTITETIT TË RI "BASKETBOLLI 3.0"

- Implementimi i identitetit të ri vizual në të gjitha eventet, platformat dhe materialet zyrtare.
- Brendimi i palestrave, eventeve dhe komunikimit institucional.
- Zhvillimi i produkteve zyrtare të brendit (MERCH).

2. RITJA E VIZIBILITETIT DIGJITAL DHE MEDIATIK

- Rritje +50% e ndjekësve dhe angazhimit në rrjetet sociale.
- Prodhim më profesional i përmbajtjes audiovizuale.
- Rritje e prezencës së FBK-së në media vendore dhe ndërkombëtare.

3. ZGJERIMI I KOMUNITETIT TË BASKETBOLLIT

- Aktivizime në shkolla dhe komunitet.
- Fushata për të rinjtë dhe familjet.
- Programe për tifozët dhe komunitetin e basketbollit.

4. PROMOVIMI I BASKETBOLLIT TË VAJZAVE DHE GRAVE

- Fushata dhe programe të dedikuara për vajza.
- Promovimi i role-modeleve dhe historive të suksesit.
- Vizibilitet më i madh i garave dhe aktiviteteve të femrave.

5. RITJA E IMPAKTIT TË EVENTEVE NDËRKOMBËTARE

- Fushata promovuese për eventet e FIBA që organizohen në Kosovë.
- Aktivizime mediatike dhe për komunitetin gjatë eventeve.
- Përvoja më të mira për tifozët dhe partnerët.

6. ZHVILLIMI I PLATFORMAVE TË KOMUNIKIMIT

- Podcast "n'rrjetë" – 12 deri 15 episode gjatë vitit.
- Storytelling për basketbollistët dhe historitë e sportit.
- Përmbajtje digjitale për YouTube, TikTok dhe rrjetet sociale.

7. RITJA E PARTNERITETEVE DHE TË ARDHURAVE NGA MARKETINGU

- Sigurimi i të paktën 3 sponsorëve të rinj.
- Rritja e të ardhurave nga MERCH (20–30%).
- Aktivizime komerciale në evente dhe projekte të FBK-së.

30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

2026 PLANI FINANCIAR




PLANI FINANCIAR

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Të hyrat e pritshme për vitin 2026

Draft buxheti i FBK-së për vitin 2026 është **€2,826,804.12**




30

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

SHIPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2026 SIPAS LINJAVE BUXHETORE

- Shpenzime të zyrës
- Pagat e stafit
- Përfaqësueset seniore të Kosovës
- Përfaqësueset e reja të Kosovës
- Trajnime/klinika për persona zyrtarë të ndesh...
- Organizimi i ligave
- Projektet Erasmus
- Basketbolli 3x3
- Organizime të FBK-së
- Evente/projekte
- Projektet me FIBA
- Udhëtimet zyrtare
- Të tjera



30

INTERPRETIMI I SHPËRNDARJES

Buxheti për vitin 2026

Federata
e Basketbollit
të Kosovës

Përfaqësueset e Kosovës

→ Prioritet strategjik për përfaqësim dhe konkurrencë ndërkombëtare

Organizimi i ligave dhe aktiviteteve vendore

→ Stabilitet dhe zhvillim i sistemit të basketbollit në vend

Eventet dhe projektet ndërkombëtare

→ Rritje e prezencës dhe reputacionit ndërkombëtar

Programet zhvillimore (të rinjtë, femrat, 3x3)

→ Investim në të ardhmen dhe zgjerim të bazës së sportit

Administrata dhe stafi

→ Mbështetje për funksionim efikas dhe menaxhim profesional

PËRFUNDIM

- Plani financiar 2026 reflekton rritje dhe ambicie zhvillimore
- Buxheti është ndërtuar mbi parime të qëndrueshmërisë dhe kontrollit financiar
- Shpërndarja e burimeve mbështet drejtpërdrejt prioritetet strategjike të Federatës
- Është siguruar balancë ndërmjet performancës sportive dhe zhvillimit afatgjatë

Shpërndarja e buxhetit reflekton balancën ndërmjet performancës sportive, zhvillimit afatgjatë dhe qëndrueshmërisë institucionale.

FALLEMINDE RIT!

